



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.154/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Deçan, për shkak të vendosjes së posterit në shtyllë elektrike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohen** si të bazuara ankesat Anr 154/2017 dhe Anr. 155/2017 të Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, kështu që subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Deçan i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,200.00 (*tremijë e dyqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar dy ankesa nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA në të cilat pretendon se me datën 07.06.2017 në rrugën fshatit Restovicë-Deçan, aktivisti i tyre ka vërejtur se në shtyllë elektrike ishin të vendosur posterit i një kandidati për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

PZAP me datë 07.06.2017 subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje ka dërguar kërkesë dhe urdhër për ndërmarrjen e veprimit për përmirësim.

Më datë 08.06.2017, PZAP-i pranoi kërkesë nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA për tërheqje të ankesës, me numër Anr. 121/4 të datës 07.06.2017, parashtruara ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartëcekura dhe i trajton si një ankesë të evidentuar me Anr 154/2017 për r shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për tre ankesat vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesat janë të bazuara**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteret e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje janë të vendosura në shtylla elektrike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterët e kandidatit për deputet nga ky subjekt janë vendosur në shtylla elektrike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është e njoftuar me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e saj është e përsëritur disa herë gjatë këtij procesi zgjedhor, dhe faktin se posteret e kandidatit për deputet nga ky subjekt janë vendosur në shtyllat elektrike.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 08.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.154/2017 dhe Anr. 155/17 të datës 07.06.2017, te parashtruara ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njëres prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administrative është parashikuar që “*Tërheqja e njëres prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve*

të tjera në procedim". Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik LVV, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.154/2017 më datën 09.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.